

**BASHKIA TIRANË**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Drejtuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Tower” shpk &”Dricons” shpk

Adresa: Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga “Fadil Rada”, Pallati “Daniela”, Shkalla 2, Kati 3, Ap.9, Nr.pasurie 6/544+2-P, Tiranë & Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga “Muhamet Gjollësia”, Pallati 34, Shkalla 3, Kati 2, Ap.29, Tiranë.

Lënda: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Procedura e prokurimit: ”Mbikqyrja e punimeve të objektit “Rindërtimi i banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim ne Njesine AdministrativeZall Herr”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-59163-05-27-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Tender i Kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e perzgjedhur në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Udhëzimit Nr. 1, datë 13.02.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 7.1, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 35/1 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,(i ndryshuar), Kreu V, Neni 41.

Publikime të mëparshme: Nuk ka

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar: Sipas short-listing të pasqyruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Tower” shpk &”Dricons” shpk NUIS L21717003H & NUIS L52013020H
2. Operatori ekonomik “Instituti Dekliada - Alb” shpk; NUIS K71606006A
3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Studio-Rebus” shpk & “47 EK 79 & Iliriada P.K.S” shpk NUIS K82409008F & NUIS K82422001O
4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Infratech” shpk & “Vler Invest” shpk NUIS K91628001D & NUIS K81721022P
5. Operatori ekonomik “Net Group” shpk NUIS L72023002P

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazen tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Tower” shpk &”Dricons” shpk  
NUIS L21717003H & NUIS L52013020H

A. Alternativa 1- Moduli betonarme

1. Modeli 1: Shtëpi 1+1, vlera 29,952 (njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy) Lekë pa tvsh;

2. Modeli 2: Shtëpi 2+1, vlera 34,317 (tridhjetë e katër mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa tvsh;
3. Modeli 3: Shtëpi 3+1, vlera 43,612.2 (dyzet e tre mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë pikë dy) Lekë pa tvsh.

B. Alternativa 2- Moduli parafabrikat

1. Modeli 1: Shtëpi 1+1, vlera 30,010.5 (tridhjetë mijë e dhjetë pikë pesë) Lekë pa tvsh;
2. Modeli 2: Shtëpi 2+1, vlera 34,392.6 (tridhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy pikë gjashtë) Lekë pa tvsh;
3. Modeli 3: Shtëpi 3+1, vlera 43,419.6 (dyzet e tre mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë pikë gjashtë) Lekë pa tvsh

2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Infratech” shpk & “Vler Invest” shpk  
NUIS K91628001D & NUIS K81721022P

A. Oferta ekonomike-Moduli betonarme

1. Modeli 1: Shtëpi 1+1, vlera 33,200 (tridhjetë e tre mijë e dyqind) Lekë pa tvsh;
2. Modeli 2: Shtëpi 2+1, vlera 38,100 (tridhjetë e tetë mijë e njëqind) Lekë pa tvsh;
3. Modeli 3: Shtëpi 3+1, vlera 48,400 (dyzet e tetë mijë e katërqind) Lekë pa tvsh.

B. Alternativa 2 – Moduli parafabrikat

1. Modeli 1: Shtëpi 1+1 me fond limit 33,300 (tridhjetë e tre mijë e treqind) lekë pa TVSH.
2. Modeli 2: Shtëpi 2+1 me fond limit 38,200 (tridhjetë e tetë mijë e dyqind) lekë pa TVSH.
3. Modeli 3: Shtëpi 3+1 me fond limit 48,200 (dyzet e tetë mijë e dyqind) lekë pa TVSH.

Renditje e pikëve totale për Alternativën 1

Bashkimi I Operatorëve ekonomikë “Tower” shpk & “Dricons” shpk = 100 pikë

Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Infratech” shpk & “Vler Invest” shpk = 69 pikë

Renditje e pikëve totale për Alternativën 2

Bashkimi I Operatorëve ekonomikë “Tower” shpk & “Dricons” shpk = 100 pikë

Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Infratech” shpk & “Vler Invest” shpk = 69 pikë

Për Alternativën 1 dhe Alternativën 2 është skualifikuar operatori ekonomik i mëposhtëm:

Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Infratech” shpk & “Vler Invest” shpk” shpk NUIS  
K91628001D & NUIS K81721022P

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Ofertat e paraqitura nga operatori i mësipërm ekonomik është identifikuar si oferta të pasuksesshme pasi referuar pikëzimit nuk arrin pikët maksimale, bazuar në mungesën e dokumentaciont të kërkuar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e Operatorëve ekonomik “Tower” shpk & “Dricons” shpk se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 100 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Përgjegjës, Bashkia Tiranë*, sigurimin e kontratës prej 15 % të vlerës së saj, siç parashikohet në Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 43, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë :21/07/ 2020

Ankesa: Në fazën e parë të procedurës së prokurimit nuk ka pasur ankesa